



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.
2. Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Europian”.
3. Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Marrin pjesë :

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia. Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Elona Hoxha, Paulin Sterkaj, Myslym Murrizi, Ervin Saliq, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunkshi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Julian Hodaj - Zëvendësministër i Brendshëm

Ilir Bejko - Drejtor i Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Armand Skapi- Drejtor i Marrëveshjeve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Migena Baholli – Përfaqësuese nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komsionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Në rendin e ditës së komsionit është parashikuar miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”. Natyrisht, bëhet fjalë për miratimin në parim të këtij kalendar. Kalendaru u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Çështja e dytë e rendit të ditës është diskutimi për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Europian”.

Çështja e tretë e rendit të ditës është diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komsionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Për të prezantuar dy projekt marrëveshjet, në këtë mbledhje kemi ftuar zëvendësministren e Brendshme, zonjën Rovenë Voda (kemi kërkuar të ishte prezent një nga zëvendësministrat e Brendshëm), zotin Ilir Bejko, drejtor i Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe zotin Armand Skapi, drejtor i Marrëveshjeve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Faleminderit!

Ishte parashikuar të ishte edhe zonja Migena Baholli, sipas dokumentit që më është vënë përpara.

Deri sa përfaqësuesit e ministrave të zënë vend në komision, do t’u lutesha kolegëve të kenë durim, që të fillojmë me prezantimin e projekt marrëveshjeve.

Për sa i takon pikës së parë të rendit të ditës, siç e thamë, është një kalendar në parim, sepse duhet të rakordojmë edhe me drejtuesit e institucioneve që do t’i dëgjojmë në diskutimin për buxhetin. Natyrisht, do të dëgjohen të dyja ministratë, që kanë edhe detyrimin ligjor të jenë prezente në komision. Ndërkohë, kemi menduar të zhvillojmë edhe disa seanca dëgjimore me përfaqësuesit e institucioneve qendrore, që kemi mundur t’i kontaktojmë gjatë kësaj kohe, si dhe të shohim problematikat që ka çdo institucion.

Besoj se jeni dakord me kalendarin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E zgjidhim për nesër.

Atëherë, fillojmë pa humbur kohë.

Zonja Voda, do të fillojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Europian.” Ju lutem, na thoni dy fjalë për këtë marrëveshje!

Nëse dikush nga përfaqësuesit e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme ose të Ministrisë së Drejtësisë do t’i shtojë diçka fjalës suaj, është i lejuar.

Fjala është për ju.

Faleminderit!

Rovena Voda– Mirëdita, zonja kryetare! Më falni për vonesën!

Në fakt, projektvendimi për propozimin e projektligjit që po diskutohet sot, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Europian”, është një projektakt në përputhje me programin politik të qeverisë. Implementimi i tij, sigurisht, do të mundësojë rritjen e efikasitetit të institucioneve ligjzbatuese në luftën kundër lëndëve narkotike.

Qëllimi afatgjatë i këtij projektakti është ofrimi i asistencës për zbatimin e legjislationit të BE-së, për identifikimin dhe vlerësimin e substancave psikoaktive të reja, riintegrimin dhe rehabilitimin e përdorësve të drogës, duke përfshirë edhe ata që kanë vuajtur dënimin në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale, si dhe zhvillimin e metodologjive të përbashkëta të autoriteteve publike në nivel lokal, rajonal, të shoqërisë civile, me qëllim uljen e numrit të veprave penale të lidhura me drogën.

Projektakti është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Shqipëria ka qenë e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë dhe memorandumin e mirëkuptimit e ka nënshkruar më 23 shtator 2016. Më pas, ky memorandum është ratifikuar me ligjin nr. 11/2017 dhe përfshin 3 komponentë, që i përkasin fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, ndërkohë që nuk përfshinte pjesën e katërt të komponentit, që lidhet me politikën e luftës kundër drogave.

Pjesa e komponentit të luftës kundër drogave të këtij memorandumi, lidhet kryesisht me asistencë financiare dhe i përket Ministrisë së Brendshme. Pra, në thelb, ndryshimi i këtij memorandumi është thjesht ofrimi i një asistence financiare, që ofrohet me një shumë të përcaktuar (për momentin nuk e kam shumën). Kjo asistencë është e ndarë në vite dhe do t'i dedikohet Ministrisë së Brendshme për komponentin që i përket kësaj ministrie.

Besoj se kjo do të jetë një vlerë e shtruar, duke qenë se i afrohem edhe procesit *screening*, që lidhet me kapitullin 24, që, në fakt, është kapitulli që i përket Ministrisë së Brendshme. Sigurisht, i tillë është edhe përafrimi i legjislacionit të veprave penale në luftën kundër drogave. Besoj se është një vlerë e shtuar në prioritetet e Ministrisë së Brendshme, pra në luftën kundër këtij fenomeni. Ky është qëllimi i këtij memorandumi.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Voda!

Zoti Skapi, nuk e di nëse doni të flisni, meqenëse ministria juaj ka marrë pjesë në lidhjen e këtij memorandumi kuptimi...?

Armand Skapi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ne si ministri e kemi mbështetur fuqimisht negociimin e këtij memorandumi, i cili shton komponentin e bashkëpunimit me Bashkimin Europian, edhe në fushën e luftës kundër drogave. Është një hap pozitiv, që ne e ndjekim edhe në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit dhe plotësimit të detyrimeve që na lindin, siç e tha edhe zëvendësministrja, në bazë të kapitullit 24 të MSA-së.

Ne kemi dhënë edhe mendimin tonë në bazë të ligjit “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, kështu që ju ftoj ta ratifikoni. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Skapi!

Fjalën e ka relatori i këtij projektligji, zoti Anduel Xhindi.

Anduel Xhindi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, dua të falënderoj parafolësit për parashtrimin që i bënë këtij projektligji!

Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Europian, është nënshkruar më 28 shtator 2016, me përjashtim të përfshirjes në këtë program të komponentit që lidhet me luftën kundër lëndëve narkotike.

Ky ndryshim i memorandumit të mirëkuptimit synon shtrirjen e fushëveprimit tematik të tij, duke përfshirë edhe objektivin, që lidhet me iniciativa në fushën e politikës së drogave,

konkretisht komponenti “Politika e luftës kundër drogave”, si pjesë e Rregullores së BE-së nr. 1382/2013, mbi të cilën mbështetet ky memorandum.

Nëpërmjet këtij ndryshimi synohet mbështetja e iniciativave në fushën e politikës së drogës, për bashkëpunimin gjyqësor dhe aspektet e parandalimit të krimit dhe luftën ndaj tij, lidhur ngushtë me objektivin e përgjithshëm të programit të drejtësisë. Memorandumi është nënshkruar nga palët në datën 12 shkurt 2018.

Për sa u përket shpenzimeve buxhetore, likuidimi i këtij detyrimi në një faturë të vetme mund të realizohet nëse njëra nga ministritë, Ministria e Drejtësisë apo Ministria e Brendshme, disponon fondet e nevojshme në buxhetin e miratuar për realizimin e pagesës së përcaktuar.

Në rastin kur vlera e faturës duhet të përballohet nga të dyja ministritë, sipas shumave të parashikuara në buxhetet e tyre përkatëse, për realizimin e pagesës nga ana e njëres ministri, është i nevojshëm të bëhet rialokimi i fondit përkatës, nga buxheti i njëres ministri në buxhetin e ministrisë tjetër, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas kriterëve dhe procedurave përkatëse.

Efektet financiare për politikën e luftës kundër drogave, që do të mbulohen nga Ministria e Brendshme, janë 6 mijë euro për secilin vit buxhetor dhe do të përballohen nga buxheti i programit “Policia e Shtetit”.

Faleminderit!

Ftoj kolegët ta miratojnë këtë projektligj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Xhindi!

A ka pyetje nga kolegët lidhur me projektligjin në fjalë? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, e mbyllim këtu prezantimin e këtij projektligji.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Marrin pjesë :

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia. Luan Duzha, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Elona Hoxha, Paulin Sterkaj Myslym Murrizi, Ervin Saliq, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunkshi dhe Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Julian Hodaj - Zëvendësministër i Brendshëm

Ilir Bejko - Drejtor i Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Armand Skapi- Drejtor i Marrëveshjeve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Migena Baholli – Përfaqësuese nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme

Ermonela Felaj – Dua të ftoj përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme, sepse do të kalojmë në prezantimin e projektligjit të dytë, “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Zonja Voda, fjala është për ju.

Rovena Voda – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Ky projektligj është shumë i rëndësishëm. Më në fund kemi bërë të mundur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

Mund të themi se Shqipëria ndoshta ka qenë një ndër vendet e fundit të Ballkanit Perëndimor që e ka nënshkruar këtë marrëveshje, pasi të gjitha vendet fqinje e kanë një marrëveshje me këtë komisioner.

Në fakt, ICMP-ja është një organizatë ndërkombëtare (më lejoni t’i bëj pak historikun), e cila në fokusin e veprimtarisë së saj ka gjetjen e personave të zhdukur për shkak të luftërave, vendeve të konfliktit apo edhe ngjarjeve të tjera të jashtëzakonshme të natyrës. Kjo iniciativë ka filluar në vitin 1996 nga presidenti amerikan Bill Clinton në samitin e G 7-ës, të zhvilluar në Paris. Në fakt, e gjithë iniciativa erdhi si pasojë e luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, ku pati me mijëra viktima të varrosura dhe të paidentifikuara.

Në fakt, ne e kemi shfrytëzuar këtë lloj marrëveshje (nëse mund ta them kështu) për të rritur bashkëpunimin për identifikimin e viktimave apo eshtrave ende të pagjetura të viktimave të regjimit komunist, të cilat mendohet se në total mund të jenë 6 mijë, megjithatë kjo mbetet për t’u parë.

Në vitin 2006 qeveria shqiptare ka bërë një përpjekje, me një rezolutë të miratuar dikur në parlament, për të dënuar çdo lloj krimi të regjimit komunist, por gjithçka ka mbetur aty dhe nuk ka pasur asnjë lloj iniciative tjetër për të përkrahur familjarët e viktimave të regjimit komunist, eshtrat e të cilëve ende nuk janë gjetur.

Për herë të parë ka pasur një deklaratë të bërë nga qeveria shqiptare, me iniciativë të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, që ka qenë dikur, e cila në tratativa me ICMP-në mori përsipër ta riniste këtë proces. Në këtë deklaratë të vitit 2014 qeveria shqiptare angazhohej në gjetjen e eshtrave, duke respektuar standardet e të drejtave të njeriut, por, në njëfarë mënyre, edhe për të vendosur në vend padrejtësitë e kohës.

Kjo marrëveshje synon intensifikimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste, kryesisht të periudhës 29 nëntor të vitit 1944 - 2 korrik 1991, por në marrëveshje është lënë një hapësirë edhe për rastet e tjera, nëse mund të lindë nevoja, sepse mund të ketë raste të personave të zhdukur edhe për shkaqe të tjera. Prandaj, kemi lënë një hapësirë në këtë marrëveshje.

Në fakt, ky është një projektakt i parashikuara në programin analitik të akteve 2018 të Minsitrisë së Brendshme. Të gjitha negociata janë kryer në përputhje me ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare. Pra, është krijuar një grup negociator që ka negociuar me përfaqësuesit e Komisionit Ndërkombëtar, sepse është një organizatë ndërkombëtare siç janë agjencitë e Kombeve të Bashkuara që veprojnë në Shqipëri, dhe pas negociatave kemi arritur në këtë memorandum bashkëpunimi me ICMP-në.

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje lidhen me gjetjen e personave të zhdukur, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit për këtë qëllim. Në fakt, ICMP-ja ka ekspertizën e duhur për të ndihmuar në identifikimin e këtyre viktimave, duke nisur me kryerjen e ADN-së apo me mënyrën se si do të kryhet ky proces.

Në këtë proces janë të përfshira një sërë institucionesh të qeverisë shqiptare. Në bazë të kësaj marrëveshjeje kemi lënë një rrugë të hapur, që, më pas, në bazë të protokolleve dypalëshe me të gjitha institucionet, mund të vendosen edhe detajet e bashkëpunimit në terren se si do të operohet. ICMP-ja ka të gjithë ekspertizën e duhur, ka ekspertizën për sa i përket identifikimit lidhur me pjesën e ADN-së, ka bashkëpunim me organizata të tilla ndërkombëtare siç është EUROPOL-i apo IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin), kështu që, unë shpresoj që qeveria shqiptare me miratimin e kësaj marrëveshjeje të mundet në njëfarë mënyre të vërë një drejtësi apo standard në respektimin e të drejtave të njeriut duke mbështetur familjarët e viktimave të atij regjimi për eshtrat e tyre ende të pagjetura.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Voda!

Relator për këtë projekt nga ana e komisionit tonë është zoti Luan Duzha.

Të dëgjojmë relatorin përpara se të vazhdojmë me pyetjet për këtë projekt marrëveshje.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu siç e tha edhe zëvendësministrja, qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

Projektligji është hartuar në përputhje me nenet 78, 83 dhe 155 të Kushtetutës, si dhe është në harmoni me ligjin nr. 43\2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo marrëveshje synon intensifikimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri midis datave 29 nëntor 1944 dhe 2 korrik 1991, duke përcaktuar në veçanti rregullat e bashkëpunimit për identifikimin, gjetjen e personave të zhdukur, si dhe për koordinimin e punës me organet kompetente. Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj marrëveshje lidhen me nevojën e gjetjes së personave të zhdukur, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit për këtë qëllim.

Sipas kësaj marrëveshjeje, ICMP-ja do të themelojë në Tiranë një zyrë shërbimi për gjetjen e personave të zhdukur duke përdorur metodat tekniko-shkencore të zbulimit dhe të identifikimit, si dhe shkëmbimin e informacionit me organet kompetente në kuadër të bashkëpunimit me qëllim realizimin e aktivitetit administrativ.

ICMP-ja do të jetë përgjegjëse financiarisht për ambientet, pajisjet dhe orenditë, për përmbushjen efektive të funksioneve të saj, si dhe do të gëzojë imunitet dhe privilegjet e garantuara për të gjitha misionet diplomatike të akredituara në Shqipëri në përputhje me Konventën e Vjenës.

Shkëmbimi i përbashkët i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve do të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës dhe atë ndërkombëtar. Shkëmbimi dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar do të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar e atë ndërkombëtar. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin e tyre, autoritetet kompetente të palëve mund të shkëmbejnë ekspertizë nëpërmjet zyrës lidhur me çështjet e parashtruara në këtë marrëveshje me qëllim thjeshtësimin dhe harmonizimin e procedurave dhe praktikave. Nisur nga kjo, i ftoj kolegët që ta miratojmë këtë marrëveshje.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duzha!

Ka pyetje nga kolegët për këtë marrëveshje?

Në vijim të përpjekjeve që ka bërë dhe bën shteti shqiptar duket një marrëveshje me goxha interes për të identifikuar raste të trishtuara të ndodhura gjatë periudhës së regjimit

komunist. Besoj se një marrëveshje e tillë do të ndikojë në marrjen e ekspertizës dhe ndihmës së duhur për identifikimin e personave, të cilët rezultojnë të zhdukur në një periudhë relativisht të gjatë (nga viti 1942 deri në vitin 1991, kur ndodhi ndryshimi i sistemit në Shqipëri).

Në momentin që është diskutuar për këto marrëveshje, a ka pasur aktorë të tjerë që janë bërë pjesë e negociatave? E kam fjalë për Autoritetin e Dosjeve apo për Institutin e Studimit të Krimeve kundër Komunizmit.

Rovena Voda – Autoriteti i Dosjeve apo Instituti i të Përndjekurve Politikë nuk kanë qenë pjesë e grupit negociator, por ne, në fakt, kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me ta, sidomos për sa i përket autoritetit të Dosjeve, për arsye sepse e gjithë praktika fillestare ka qenë një procedurë e nisur më parë. Unë përmenda deklaratën e nënshkruar në kohën kur ekzistonte Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Autoriteti ka qenë në varësi të asaj ministrie. Pati filluar një procedurë negocimi. Pra, kishim një bazë të vogël në një negociim me ICMP-në dhe kemi qenë në kontakte me drejtuesin e Autoritetit të Informimit të Dosjeve. Ata kanë edhe vetë marrëveshje bashkëpunimi dhe komunikim me ICMP-në, Komisionin Ndërkombëtar për Njerëzit e Zhdukur, prandaj në marrëveshje ne kemi lënë të hapur mundësinë e bashkëpunimit me çdo institucion tjetër, Autoritetin apo Institutin e të përndjekurve. Kjo do të rregullohet me protokolle të veçanta që ata kanë. Unë e di që ata do të bashkëpunojnë ngushtë, sepse, nga sa jam informuar nga zonja Sula, në bazë të dëshmive që ato kanë mbledhur nga disa familjarë të ish-të përndjekurve, kanë identifikuar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë disa vende ku mendohet që mund të ketë varreza me eshtra të personave të zhdukur. As Instituti dhe as Autoriteti nuk kanë kapacitete, por në bashkëpunim me ICMP-në, me organet e qeverisjes vendore, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe me prokurorinë, do të mund të realizohet ky proces. Pra, janë në dijeni të kësaj marrëveshjeje.

Ermonela Felaj - Zonja Voda, në dijeninë tuaj, a ka shteti shqiptar sot një listë apo draft-listë të personave të zhdukur? Brenda sa kohësh mendohet të bëhet valide zyra për identifikimin e personave të zhdukur?

Rovena Voda – Unë besoj se pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga Kuvendi i Shqipërisë, zyra e komisionerit në Shqipëri do të jetë gati. Besoj se ata i kanë kapacitetet. Për sa i përket listës, nga kontaktet që unë kam pasur me zonjën Sula, e cila ka qenë e ftuar në ceremoninë ku ne kemi firmosur këtë marrëveshje ...

Dua të theksoj se ka një fond të Bashkimi European që do të mbështesë ICMP-në për të ndihmuar në gjetjen e eshtrave të personave të zhdukur këtu. Kur e kemi firmosur këtë marrëveshje kanë qenë të ftuar zonja Sula, por edhe ish-të përndjekur, dhe nga diskutimet që u bënë, sepse eventit që bëme ishte në një formë diskutimi, u tha se ekzistojnë lista të personave të zhdukur, me emër, mbiemër, të përcaktuar qartë, madje edhe harta për të treguar një vendndodhje se ku mund të gjenden eshtrat e këtyre personave. Më vjen keq që nuk mund të jap një numër të saktë, por ka. Pra, ka një listë me emrat e personave të zhdukur. Nga rrëfimet e familjarëve mendohet se mund të gjendet edhe vendndodhja ku mund të ndodhen edhe eshtrat e të zhdukurve.

Ermonela Felaj – Faleminderit për shpjegimet!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Braho.

Spartak Bravo – Po për të zhdukurit pas vitit 1991 keni ndonjë detyrim?

Rovena Voda – Zoti Braho, faleminderit për pyetjen!

Në fakt, kjo pyetje ka qenë që në momentin që ne filluam negociatat.

Duke qenë se unë jam edhe koordinatorë kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore, e di që për shtetin shqiptar pas vitit 1991 ka qenë një plagë edhe zhdukja e personave për shkaqe nga më të ndryshmet. Me iniciativë personale kam insistuar edhe vetë, por kam gjetur edhe mbështetjen e të gjithë grupit negociator që të lëmë të hapur mundësinë për raste të tjera kur qeveria shqiptare e çmon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, parashikohet.

Ne e kemi lënë të hapur një dritare që edhe për ato raste të zhdukjes së personave për arsye të tjera, ne të mundemi të shfrytëzojmë bashkëpunimin me Komisionin Ndërkombëtar për Njerëzit e Zhdukur, që ka ekspertizën e duhur, për të ofruar asistencë, bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni për të ndihmuar sa të mundemi, duke qenë se unë thashë që ICMP-ja ka një bashkëpunim shumë të ngushtë edhe me agjenci të huaja si EUROPOL-i apo IOM-i, sepse jemi në kushtet e migracionit të paligjshëm, të trafikimit, por edhe raste të tjera të zhdukjes së personave.

Duke qenë se ka ekspertizën e duhur, kemi menduar ta shfrytëzojmë edhe për këtë pjesë.

Ermonela Felaj – Kam edhe unë diçka për të plotësuar pyetjen e zotit Braho. Cili është reputacioni i Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur deri më sot?

Rovena Voda – Mund të them se është organizata e vetme ndërkombëtare e specializuar që ka të gjitha kapacitetet dhe që në fokus të veprimtarisë së saj ka vetëm gjetjen e personave të zhdukur për shkak të konflikteve, të luftërave, të zhdukjeve me forcë apo edhe për shkaqe të fatkeqësive natyrore. Kjo organizatë është krijuar në vitin 1996 me iniciativë të presidentit amerikan Bill Clinton. Ka pasur rezultate shumë të mëdha dhe të prekshme në shtetet fqinje të Ballkanit, siç është Bosnja dhe Hercegovina pas luftës me Serbinë, ku me ndihmën e komisionerit dhe ICMP-së është mundësuar gjetja e eshtrave të mijëra të zhdukurve nga kjo luftë.

Ermonela Felaj – ... drejtë. Unë besoj se duhet t'i japim më shumë vend bërjes së njohur të kësaj projekt marrëveshje për të gjitha ato institucioneve që nesër, me ngritjen e zyrës së Komisionerit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, do të jenë të detyruar të bashkëpunojnë. Në fakt, këtu nuk janë thjesht vetëm Autoriteti i Dosjeve dhe Instituti i Krimeve kundër Komunizmit, por edhe prokuroria dhe policia me të dhënat që ka.

Ndërhyrja që bëri zoti Braho është shumë e drejtë. Nuk është vetëm problemi i atyre personave, patjetër që ajo vijon të ngelet një plagë e hapur për shoqërinë, por kemi edhe persona në një periudhë tjetër, që është periudha e demokracisë, çka e bën edhe më të ...

Neve na duhet ne që të investojmë më shumë përgjegjësi në të gjithë këtë.

Sidoqoftë, faleminderit për prezantimin nga ana juaj!

Meqenëse nuk kemi votuar, nëse ka diskutime për të dyja marrëveshjet, ju ftoj t'i bëni. Për marrëveshjen e parë, që ndihmon Ministrinë e Brendshme në luftën kundër drogës dhe marrëveshjen e dytë për identifikimin e personave të zhdukur, ka ndonjë diskutim?

Atëherë, meqenëse diskutime nuk ka dhe marrëveshjet janë të qarta, i ftoj kolegët që të votojmë.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit që ndryshon Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit European”.

Kush është dakord në parim me këtë marrëveshje?

Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1 të kësaj marrëveshjeje?

Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, që përcakton hyrjen në fuqi?

Faleminderit!

Kush është dakord me marrëveshjen në tërësi?

Faleminderit! Kundër dhe abstenim nuk ka.

Vazhdojmë me votimin e projekt marrëveshjes së dytë.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)?

Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 1 të kësaj projekt marrëveshjeje?

Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, që përcakton hyrjen në fuqi brenda 15 ditëve?

E votojmë në tërësi.

Kush është dakord me projekt marrëveshjen?

Faleminderit!

Faleminderit të gjithë përfaqësuesve të të gjitha ministrive për prezencën e tyre!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA